

## **Te drejtat e qytetareve te percaktuara ne rregulloren per kerkesat, ankesat, peticionet dhe iniciativat qytetare.**

( informacion me i detajuar per procedurat gjendet ne web e Bashkise, seksioni Keshilli Bashkiak, nenseksioni Rregullore =Rregullorja e kerkesave, ankesave, peticioneve)

### **Neni 67**

#### **Ankesa ndaj vendimit të këshillit për peticionin**

1. Nëse parashtruesit e peticionit nuk janë të kënaqur me përgjigjen dhe veprimin e komisionit të përhershëm përkatës në lidhje me kërkesën e peticionit, mund t'i dërgojnë këshillit një ankesë me shkrim. Ankesa do të trajtohet sipas procedurave të ankesave që ka miratuar Këshilli. Kryesia e Këshillit shqyrton aspektet e respektimit të procedurës së shqyrtimit të peticionit nga komisioni, dhe Kryetari i Këshillit i kthen përgjigje me shkrim parashtruesit kryesor, për vendimin e kryesisë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e regjistrimit në Bashki të ankesës. Nëse ankesa vlerësohet e drejtë, Kryesia vendos rishqyrtin e peticioni në Mbledhjen e Këshillit më të parë të radhës.
2. Nëse vendimi i refuzimit të peticionit është marrë nga Këshilli, Kryesia e Këshillit shqyrton respektimin e procedurës në procesin e shqyrtimit të peticionit, dhe Kryetari i Këshillit i kthen përgjigje me shkrim parashtruesit kryesor, për vendimin e Kryesisë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e regjistrimit në Bashki të ankesës. Nëse ankesa vlerësohet e drejtë, Kryesia vendos rishqyrtimin e peticionit në mbledhjen më të afërt të radhës të Këshillit.
3. Nëse parashtruesit e peticionit janë të pakënaqur me vendimin e Këshillit, mund t'i drejtohen gjykatës administrative.

### **Neni 90**

#### **Ankimi ndaj vendimeve të këshillit bashkiak në lidhje me iniciativën qytetare**

1. Përfaqësia e Iniciativës mund të ankohet kundër vendimit të Këshillit për refuzimin e pranimit paraprak të peticionit, refuzimin e marrjes së fletëve të nënshkruara, apo refuzimin e miratimit të iniciativës.
2. Për rastet e ankesave të cituara në pikën një (1) më sipër, Përfaqësia e Iniciativës mund ti drejtohet gjykatës administrative të rrethit gjyqësor.

